



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

NR. _____ Prot

Tiranë, ____/____/2021

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM
NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL NË KATEGORINË E MESME DHE TË
ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II dhe të III të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.242, datë 18.03.2015 "Për Plotësimin e vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e Lëvizjes Paralele, Ngritjes në Detyrë dhe Pranim nga Jashtë në Shërbimin Civil, për pozicionin:

Nd/Komisioner në Seksionin e Organeve të Administratës Qëndrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, Kategoria II-b

Pozicioni i mësipërm u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele !

Vetëm se në rast se në përfundim të procedurës të Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vacant, atëherë është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës të Ngritjes në Detyrë dhe Pranim nga Jashtë shërbimit Civil.

Për procedurën e Lëvizjes Paralele data e fundit e dorëzimit të dokumentave është data 9.09.2021.

Ndërsa për Procedurën e Ngritjes në Detyrë dhe Pranim nga Jashtë Shërbimit Civil është data 14.09.2021

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin "Nd/Komisioner" në Seksionin e Organeve të Administratës Qëndrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari te Tyre është:

Trajton rastet që përcillen nga eprorët, sipas fushave dhe të drejtave që mbulon.

Propozon rastet që mund të ndiqen me inisiativë, të bera publike në median e shkruar apo vizive.

Kryen inspektime pranë organeve të administratës qendrore apo vendore, si edhe në terren, dhe vende ku ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut.

Harton rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Monitoron zbatimin e konventave të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe përgatit informacione apo rekomandime për raportet periodike të monitorimit të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

Merr pjesë në grupet e hartimit të raporteve të veçanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala gjatë hartimit të tyre.

Është aktiv në mediat vizive dhe të shkruara me intervista apo edhe emisione të drejtpërdrejta mbi problematika të caktuara.

I-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

2.Kushtet për lëvizjen Paralele dhe kriteret e veçanta për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që veprojnë për Llogari të Tyre.

Kandidatët për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda së njëjtës kategori (kategoria II-b);

Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);

Të ketë të paktën një vlerësim “Shumë mire” ose “Mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

-Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkenca Juridike.Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë; (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

-Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një vendi tjetër të BE-së;

-Të ketë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion në administratën publike;

-Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2.Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve nëpërmjet postës elektronike në adresën:

marjetasanxhaku@avokatipopullit.gov.al dokumentat si më poshtë vijon:

a.Letër Motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës me një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë active e-mail-i për komunikim.

b.Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentacionin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakant/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

c.Fotokopje e Diplomës.

ç.Fotokopje e Libresëz së Punës

d.Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 9.09.2021.

3.Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve në institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta , si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik.

Në të njëjtën datë do të njoftohen kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave.Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve e cila njofton në mënyrë individuale , nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të parqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe pritjes së Qytetarëve brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e shpalljes së listës.Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

4.-Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin “Nd/Komisioner” në Seksionin e Organeve të Administratës Qëndrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, do të vlerësohen në lidhje me:

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

Ligjin nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar
Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
Ligjin nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar
Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
Ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
Ligjin nr.90/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore”;
Ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar;
Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar;
Ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
Rregulloren e Brendshme të institucionit të Avokatit të Popullit.

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me :

Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

Eksperiencën e tyre të mëparshme ;

Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve , mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike:

[www.dap.gov.al](http://dap.gov.al)<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.-Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut pranë institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan Dark”, nr.2, Tiranë.

II-NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në fillim të kësaj shpalljeje , në përfundim të procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, atëhere ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së Ngritjes në Detyrë dhe Pranimit nga jashtë Shërbimit Civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunës civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për Ngritjen në Detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Ngritjes në Detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-a ose III-a/1;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni-;
- Të ketë të paktën një vlerësim “Shumë mirë” ose “Mi (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Kandidati për pozicionin “Nd/Komisioner”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qëndrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, duhet të plotësojë kriteret e vecanta si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkencat Juridike edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë; (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë Institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një vendi tjetër të BE-së;
- Të ketë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion në administratën publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve nëpërmjet postës zyrtare ose nëpërmjet postës elektronike në adresën marjetasanxhaku@avokatipopullit.gov.al dokumentat si më poshtë vijon:

a.Letër Motivimi për aplikim në vendin e punës me një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail për komunikim.

b.Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/2019-udhezime-dokumenta>

c.Fotokopje e Diplomës;

ç.Fotokopje e Librezës së Punës;

d.Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi deri në datën 14.09.2021, në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi dhe intervista.

Kandidatët që konkurrojnë për pozicionin “Nd/Komisioner në Seksionin e Organeve të Administratës Qëndrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, do të vlerësohen në lidhje me :

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
Ligjin nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
Ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
Ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
Ligjin nr.90/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore”;
Ligjin nr.139.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar;
Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar;
Ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Mënyra e vlerësimit të Kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a-Vlerësimi me shkrim deri në 40 pikë;
- b-Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c-Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2 datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike në adresën: www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezime-nr-2-date=27=03-2015>

III.-PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së Pranimit në Shërbimin Civil.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe kriteret e veçanta

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

- a.-Të jetë shtetas Shqiptar
- b.-Te ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c.-Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d.-Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e.-Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje ;
- f.-Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar siaps ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkencat Juridike.Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njehsuara paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave siapas legjislacionit në fuqi).
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një vendi tjetër të BE-së;
- Të ketë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në administratën publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Prtjes së Qytetarëve nëpërmjet postës zyrtare ose nëpërmjet postës elektronike në adresën : marjetasanxhaku@avokatipopullit.gov.al dokumentat si më poshtë vijon:

- a.- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standart>

- b.-Fotokopje Diplomës (përfshirë edhe Diplomën Bachelor);
- c.-Fotokopje e Libresëz së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d.-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e.-Fotokopje të Letërnyoftimit (ID);
- f.-Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g.-Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër duhet të dorëzohet me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion brenda datës 14.09.2021.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve është e njëjtë si për procedurën e Ngritjes në Detyrë.

Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e Ngritjes në Detyrë dhe procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil do të marrin informacion në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure.

- Për datën e daljes së rezultatit të verifikimit paraprak;
- Vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.